

MARREVESHJE E TRASFERIMIT TE KUOTAVE

Lidhur me 29. 01.1997 ndermjet **Penang Shipbuilding & Construction SND BHD**, a company, nje shoqeri e organizuar dhe qe egziston ne baze te legjislacionit te Maleizise dhe adresen e saj zyrtare ne Ming Building , kati 11-te, Jalan Bukit Nanas, 50250 Kuala Lumpur, Maleizi (me poshte e referuar si " **PSC** "), dhe **Di Vincenzo Estero S.r.l**, nje shoqeri e organizuar ne baze te legjislacionit Italian dhe me zyra te regjistruara ne Via Aterno No. 78, S. Giovanni Teatino (CH), Itali (me poshte e referuar si " **DVE** ") se bashku do te rreferohen si " **Palet** ".

PARATHENIE

Meqenese , me 29 Nendor 1996 Palet kane krijuar nje joint - venture (me poshte e referuar si " **Marreveshja e Joint - Venture** " dhe qe eshte e bashkelidhur ne Aneksin A) per ndertimin dhe manaxhimin e Qendres Tregtare te Biznesit ne Tirane (me poshte e referuar " **WTC** ").

Meqenese, ne baze te Marreveshjes se Joint-Ventures, Palet do te operojne per qellimet e siperpermendura me mjetet e " Di Vincenzo Estero Albania" Sh.p.k nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar e zoteruar krejtesisht nga DVE-ja (me poshte e referuar si " **Shoqeria e Projektit** ").

Meqenese, ne baze te Marreveshjes se Joint - Ventures Palet pritet te hyjne ne nje marreveshje te transferimit te kuotave sipas te ciles DVE-ja do ti transferoje PSC-se titullin e 80 (tetedhete kuotave) te Shoqerise se Projektit, e barabarte me 80% te kapitalit themeltar te Shoqerise se Projektit (me poshte te referuara si " **Kuotat** ").

Meqenese , me 29.01.1997, Mbledhja e Ortakeve te Shoqerise se Projektit ka aprovuar transferimin e kuotave nga DVE-ja tek PSC-ja. Nje kopje e ktij vendimi do te bashkelidhet ne Aneksin B.

Meqenese, duke hyre ne marreveshjen e tanishme te transferimit te kuotave (me poshte e quajtur " **Marreveshja** ") Palet synojne te rregullojne konditat ne baze te se cilave PSC do te bleje Kuotat nga DVE-ja.

Sot Palet Bien dakort si me poshte:

Neni I Perkufizimet

Seksioni 1.01 Perkufizimet e Pergjitheshme

Kudo qe te percaktohet ne kete marreveshje, pervec kur percaktohet ndryshe, ose kur konteksi do ta kerkoje ndryshe kushtet e percaktuara ne Marreveshjen e Joint - Ventures do te kene te njejtin kuptim edhe ne kete marreveshje, dhe termat e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:



Themelimi Nenkupton, ne lidhje me çdo shoqeri, korporate, partneritet, agjensi qeveritare ose persona juridike, kontraten e themelimit, statutin dhe aktin e konstitucionit, memorandum ose dokumente te njejta me to.

Dokumenta Financiare

Nenkupton bilancin dhe llogarite e fitimeve dhe humbjeve te Shoqerise se Projektit deri me 31 Dhjetor 1996, qe do ti jepet PSC-se nga DVE - ja dhe do te bashkelidhet ne Aneksin C.

Çmimi i Kuotes Nenkupton çmimin prej 800 (teteqind) US\$.

Seksioni 1.02 Njejesi/Shumesi, Personat - Referencat - Titujt

(a) Ne kete marreveshje, pervec kur konteksi e kerkon ndryshe, fjalet qe percaktojne njejesin perfshijne edhe shumesisin dhe e kunderta, dhe fjalet qe percaktojne personat perfshijne edhe korporata, partneritete dhe persona juridike.

(b) Ne kete marreveshje, referimet per nene, seksione, anekse ose programe te veçanta do te merren si referenca te veçanta te ketij neni, seksioni, aneksi apo programi te kesaj marreveshjeje.

(c) Titujt jane perdorur vetem per te referuar dhe nuk influencojne ne interpretim e kesaj Marreveshjeje.

Neni II Perfaqesimet, Garancite dhe Marreveshjet

Seksioni 2.01 Perfaqesimet dhe garancite nga PSC - ja dhe DVE - ja.

Secila prej tyre, PSC-ja dhe DVE-ja perfaqesojne dhe garantojne si me poshte:

- (a) te kene kompetence te plote per te bere kete Marreveshje;
- (b) kjo Marreveshje ka qene e autorizuar ne menyre te ligjshme dhe ekzekutuar nga personat kompetente perben nje impenjim te vlefshem, ligjor dhe te detyrueshem brenda kushteve te saj;
- (c) lidhja e kesaj Marreveshjeje dhe perputhja me kushtet e saj nuk cenon aktet e saj te themelimit ose ndonje dispozite te ndonje marreveshjeje apo instrumenti ne te cilen eshte pale ose me te cilen eshte e detyruar, ose ne nje statut, ligj, rregull, rregullore, vendim gjyqi, dekret, urdher ne zbatim te tyre.

Seksioni 2.02

Perfaqesimet dhe Garancite e metejshme nga DVE-ja.

DVE-ja ne vijim perfaqeson dhe garanton:

- (a) ka titull te plote, ekskluziv dhe te paster mbi Kuotat e saj. Kuotat jane te lira nga detyrim, peng, ose mase tjeter sigurimi ose kufizim. Asnje person nuk ka ndonje te drejte prioritare te bleje apo te nenshkruaje ndonje Kuote.
- (b) qe nga themelimi, Shoqeria e Projektit ka mbajtur dhe perdorur librat kontabel dhe dokumentata ku pasqyrohen pasurite, pronat e saj, pergjejesite, detyrimet, aktivitetet dhe rezultatet e operimit te tyre (duke perfshire ceshtjet lidhur me taksat) ne perputhje me parimet e pergjitheshme kontabel te pranuar.
- (c) Dokumentat Financiare pasqyrojne me vertetesi dhe ndershteri pozicionet financiare dhe rezultatet e operacioneve te Shoqerise se Projektit deri me 31 Dhjetor 1996.
- (d) Dokumentat Financiare jane hartuar ne perputhje me parimet e pergjishme kontabel te pranuar.
- (e) Librat dhe dokumentat e Shoqerise se Projektit jane mbajtur mbi bazen e kronologjise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- (f) qe nga lidhja e Marreveshjes se Joint - Ventures, Shoqeria e Projektit ka vazhduar aktivitetin ne rrjedhen normale.
- (g) qe nga lidhja e Marreveshjes se Joint - Ventures, Shoqeria e Projektit nuk ka diponuar ose te kete rene dakort per te diponuar ndonje pasuri, ose te marre persiper pergjejesi te tjera pervec atyre te rrjedhes se zakonshme te aktivitetit.
- (h) qe nga lidhja e Marreveshjes se Joint-Ventures, Shoqeria e Projektit nuk ka hyre ne ndonje marreveshje, pervec aktivitetit te zakonshem, qe mund te influencoje ne thelb pozicionin e Shoqerise se Projektit.
- (i) kopjet e statutit te Shoqerise se Projektit qe do t'i jepen PSC-se nga DVE-ja dhe qe do te bashkengjiten ne Aneksin D jane te plota dhe te rregullta ne te gjithe aspektet.
- (m) ne baze te njohurive te DVE-se, nuk ka asnje akt qe paraqet rrezik ose nga i cilit kondicionohet, poces ligjor per ose kunder Shoqerise se Projektit.
- (n) ne baze te dijenive te DVE-se, Shoqeria e Projektit ka zbatuar ligjin ne te gjitha aspektet dhe nuk eshte ne shkelje te ndonje ligji, urdheri, rregulloreje ose urdher te zbatueshem ndaj Shoqerise se Projektit.

(o) ne baze te dijenive te DVE-se, Shoqeria e Projektit ka te gjithë aprovimet e qeverise te kerkuara ne Shqiperi per kryerjen e aktivitetit te saj. Te gjithë keto aprovime te qeverise jane ne fuqi, dhe ne baze te dijenive te DVE-se, nuk ka rrezik per ndonje pezullim ose shfuqizim te tyre. Asnje nga keto aprovime, per kushtet qe parashikon, nuk rrezikon te bjere nga fuqia ose te behet subjekt i ndonje revokimi si rezultat i ketij transaksioni.

(p) ne baze te dijenive te DVE-se, Shoqeria e Projektit ka plotesuar, ne kohen e duhur, te gjitha raportet qe kerkohen nga organet kompetente Shqiptare. Keto raporte kane qene reale dhe korrekte ne te gjitha aspektet, dhe jane bere pagesat ne kohe te te gjitha taksave qe duhen paguar ligjerisht si rezultat i ketyre raporteve dhe te gjitha taksat qe duhen paguar ne baze te ligjit organeve kompetente shqiptare te taksave jane paguar. Shoqeria e Projektit nuk ka marre ndonje njoftim nga ndonje autoritet taksash lidhur me ndonje problem per rregullshmeri te ketyre raporteve ose ndonje mosmarreveshje ose venien te ngjashem me autoritetet e taksave lidhur me ndonje çeshtje qe ka te beje me pergjegjesi ne lidhje me taksat.

Seksioni 2.03 Perfaqesim dhe garanci te metejshme nga PSC-ja

PSC-ja me tej perfaqeson dhe garanton se:

- (a) ajo ka dijeni, dhe pranon permbajtjen e Dokumentave Financiare te Shoqerise se Projektit.
- (b) ajo ka njohuri, dhe pranon permbajtjen e satutit ne fuqi te Shoqerise se Projektit.

Neni III

Marreveshja e transferimit te kuotave

Seksioni 3.01 Transferimi i kuotave

(a) DVE-ja shet dhe i transferon PSC-se titullin per Kuotat, dhe PSC-ja pranon dhe blen nga DVE-ja ne baze te pagimit te Çmimit te Kuotes, te lire nga çdo pergjegjesi, peng ose mase tjeter sigurimi, te drejte ose pengese dhe krejt te paster.

(b) Ne zbatim te Marreveshjes aktuale:

(i) PSC-ja do te paguaje ne kesh DVE-se Çmimin e Kuotave

(ii) Palet do te procedojne me rregjistrimin e marreveshjes aktuale dhe dokumentat qe lidhen me te ne Librin e Ortakeve, Gjykatën e Tiranës dhe çdo autoritet tjeter lokal te kerkuar nga ligji.

Neni IV

Te ndryshme

Seksioni 4.01 Taksat

Pervec taksave qe duhen paguar nga DVE-ja ne lidhje me ritjene ne kapital dhe shitjen e Kuotave, PSC-ja do te jete pergjegjese per pagimin e te gjithë taksave, detyrimeve ose pagesa te tjera (perفشire detyrimet e per vulat), te pagueshme ose lidhur me, egzekutimin, pergatitjen dhe venien ne zbatim te kesaj Marreveshjeje, ose shitje,

transferim ose dergim i Kuotave, dhe çdo dokument lidhur me sa me sipër, PSC-se, dhe PSC-ja do të ripaguajë DVE-ne për secilin nga taksat dhe detyrimet, ose pagesa të tjera (duke përfshirë taksën e vules) të paguara eventualisht nga DVE-ja.

Seksioni 4.02 Njoftimet

Çdo njoftim ose kërkesë e kërkuar ose e lejuar për tu bërë ose e bërë do të realizohet në formë të shkruar, dhe do të kërkohej të jete dhënë në mënyrën e duhur ose të bëhet e rregullt kur ajo dërgohet me dorë, me postë ajrore, ose me telefax. Pales të cilës kërkohej ose lejohet të jepet ose bëhet në atë adresë të Pales së specifikuar më poshtë ose në atë adresë tjetër që kjo Pale do të ketë përcaktuar me njoftim të Pales që jep ose ben këtë kërkesë apo lajmerim.

Per PSC-ne:

Penang Shipbuilding & Construction SDN BDH
11th Floor, Ming Building
Jalan Bukit Nanas
50250 Kuala Lumpur
Malezi,
Adresë alternative për telefax: (60) 3 2024037

Per DVE-ne:

Di Vincenzo Estero srl
Via Aterno, 78
S. Giovanni Teatino (CH)
Itali
Adresë alternative për telefax: (39) 85 4461559

Seksioni 4.03 Firmosja dhe Zbatimi

(a) Asnjë nga Palet e sipërpermendura nuk mund të nënshkruajë ose të transferojë të gjithë apo një pjesë të të drejtave ose detyrimeve të saj me pas, pa një pëlqim me shkrim të Pales tjetër.

(b) Subjekt i sa më sipër, kjo Marreveshje do të jete e detyrueshme në favor të personave respektive që do të firmosin dhe zbatojnë për Palet.

Seksioni 4.04 Mungesa e detyrueshmerisë

Në qoftë se ndonjë term, kompromis apo kusht i kesaj Marreveshjeje, ose zbatimi i tyre ndaj ndonjë personi apo rrethane, është bërë i pamundur, ose i pazbatueshem, pjesa tjetër e kesaj Marreveshjeje, ose zbatimi i një termi të tillë ose dispozite ndaj personave apo rrethanave të tjera nga ata ndaj të cileve është i pavlefshëm ose e pazbatueshme, nuk

do te influencohet , dhe do te jete i vlefshem dhe i zbatueshem deri ne kufijte e lejuar nga ligji.

Seksioni 4.05 Amendamentet

Kjo Kontrate mund te modifikohet ne forme te shkruar vetem duke krijuar nje Aneks te saj firmosur ne menyre te rregullt nga te dy Palet.

Seksioni 4.06 Gjuha Angleze

(a) Te gjitha njoftimet ose komunikimet qe do te jepen ose behen sipas kesaj Marreveshjeje, do te jene ne gjuhen angleze ose, nese do te jene ne ghuhe tjeter, do te shoqerohen nga perkthimi ne Anglisht i vertetuar nag perfaqesuesi i Pales perkatese qe jep ose ben kete njoftim apo komunikim.

(b) Te gjitha dokumentat zyrtare te Shoqerise se Projektit, duke perfshire por jo duke u kufizuar ne, proces verbale, raporte dhe llogarite do te jene ne gjuhen angleze. Kur kerkohet nga ligji, dokumentat e permendur, proces verbalet dhe llogarite do te mbahen gjithashtu ne gjuhen shqipe.

Seksioni 4.07 Ligji baze i Marreveshjes dhe Arbitrazhi

(a) Kjo Marreveshje do te qeveriset dhe lidhet ne baze te ligjit anglez.

(b) Çdo mosmarreveshje, kontradikte ose pretendim qe do te linde nga kjo Marreveshje, ose shkelje, mbyllje ose pavlefshmeri te sa me siper, do te dergohet dhe do te zgjidhet perfundimisht ne perputhje me rregullat Arbitrazhit , UNCITRAL, qe do te jene ne fuqi ne ditën e lidhjes se kesaj Marreveshjeje. Do ket nje arbitër, dhe autoriteti i cili do ta emeroje ne perputhje me rregullat UNCITRAL do te jete Gjykata e Londres e Arbitrazhit Nderkombetar. Ne rastet kur rregullat e arbitrazhit UNCITRAL nuk kane parashikuar nje situatë te caktuar Arbitri , me kompetece te plote do te percaktoje çfare veprimesh do te kryhen dhe vendimi i Arbitrit do te jete i formes se prere. Vendi i arbitrazhit do te jete Londra. Gjate procedurave te arbitrazhit do te perdoret gjuha angleze.

Seksioni 4.08 Pjeset dhe gjuha

(a) Kjo Marreveshje do te realizohet ne pjese te ndryshme , dhe secila prej tyre do te konsiderohet si origjinale, por te gjitha do te perbejne te njejten marreveshje .

(b) Kjo Marreveshje eshte hartuar ne gjuhen Angleze.

Palet e mesiperme, veprojne nepermjet perfaqesueve te tyre ligjore te autorizuar, firmosin kete marreveshje ne datën e shkruar me siper

DI VINCENZO ESTERO S.r.l

Nga: Antonio Napoleone

Titulli: Manager

Date: 29.01.1997

PENANG SHIPBUILDING & CONSTRUCTION

Nga: Thangaya A/L Munusamy

Titulli: Perfaqesuesi ligjor

Date: 29.01.1997

